



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi ShA” të datës 26.03.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Menaxhimi i mbeturinave” me nr. të prokurimit 616-24-11988-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi ShA” të datës 26.03.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Menaxhimi i mbeturinave” me nr. të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi ShA” (tutje “parashtruesi”) me datë 26.03.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Menaxhimi i mbeturinave” me nr. të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit: në kërkesë nuk është arritur që të formulohet asnjë pretendim ankimor lidhur me kërkesat e DT. Parashtruesi në kërkesën e tij vetëm propozon që të anulohet komplet aktiviteti i prokurimit në fjalë dhe të vazhdohet kontraktimi sipas rregullores së menaxhimit të mbeturinave”.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, duhet sqaruar se parashtruesi funksion si ndërmarrje publike rajonale ku Komuna e Prishtinës ka shumicën e pronësisë respektivisht aksioneve të shoqërisë. Sidoqoftë nuk qëndron argumenti i parashtruesit sipas të cilit ky aktivitet është duke u manifestuar me shkelje ligjore dhe të kontratës ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe parashtruesit. Fillimisht aktiviteti i prokurimit është duke u zhvilluar në përputhje me LPP dhe jo mbi bazën e rregulloreve të brendshme të parashtruesit. Për më tepër ky aktivitet i prokurimit është iniciuar me kërkesën e njësisë kërkuuese me të cilën ka qenë e bashkangjitur edhe deklarata për disponueshmërinë e fondeve. Ndërsa vet kërkesa e njësisë kërkuuese ka qenë e bazuar në vendimin e ZKA – Kryetarit të Komunës së Prishtinës për shpalljen e gjendjes emergjente në fushën e menaxhimit të mbeturinave në kryeqytet. Vlen të shtohet se ky aktivitet i prokurimit është duke u monitoruar edhe nga KRPP por tanimë ka kaluar edhe fazën e shqyrtimit të një ankese në OSHP. Në asnjë rast këto organe mbikëqyrëse në fushën e prokurimit publik nuk kanë konstatuar se janë plotësuar kushtet sipas nenit 62 të LPP lidhur me nenin 43.8 të RRPP për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Sa i përket vet kërkesës së parashtruesit, duhet fokusuar faktin që në kërkesë nuk është arritur që të formulohet asnjë pretendim ankimor lidhur me kërkesat e DT. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 01.04.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.